



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	22.06.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 135/4
PËR/ZA/TO:	Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.47/2017 të dt. 08.06.2017 për lëndën Orhan Vogël Nr.04-353/01-40971 për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim në ngastrën kadastrale Nr. 03714-2

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.

23.06.2017
Arben Shkurti
Premier për Zana Belushi



UVRË MEY
INSTITUT KOSOVË PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE
INSTITUT ZA ZAŠTITU SPOMENIKA KOSOVA
THE KOSOVO INSTITUTE FOR CULTURAL MONUMENT PROTECTION
Nr. 315, 22.06.2017
PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 47/2017
Datë: 08.06.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i Projektit për ndërtimin e objektit shtwpi individuale pwr banim nw ngastrwn kadastrale Nr. 03714 – 2, Z.K – Prizren”.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Orhan Vogël nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për ndërtimin e objektit - shtëpi individuale për banim, etazhiteti S+P+1 (Nr. Parcelës 03714-2). Objekti që do të ndërtohet gjendet në Zonën e VII-të (zona e banimit - struktura organike) sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, ku etazhiteti i lejuar është një deri dy kate (lartësia maksimale deri te streha është 6.5m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet 50% e sipërfaqës së parcelës. Në parcelë të lartëcekur nuk ka ndërtesë ekzistuese, përveç rrënojave të objekteve të mëhershme dhe vendi është i mbushur me shkurre. Në afërsi të parcelës ku do të ndërtohet objekti gjendet Kisha Shën Gjergjit që gjendet në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (10.10.2016 – 10.10.2017). Objekti është në rrugën "Ismet Jashari Kumanova" Nr. 101.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si më poshtë:

1. Aprovohet me kushte kërkesa e Orhan Vogël për ndërtimin e për ndërtimin e objektit - shtëpi individuale për banim, etazhiteti S+P+1, në ngastrën kadastrale 03714 – 2 në Prizren, e cila është në pajtim me kriteret e përcaktuara për Zonën e VII-të sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit.
2. T'i bashkangjitet Projektit Kryesor Incizimi gjeodezik dhe kuotat nivelore në Prekje të projektit në bazë të incizimit gjeodezik.
3. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK-Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK - Prizren (një për QRTK - në dhe një për IKMM-në).

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;

